

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

Nr./Br. 413/01-06
Data/Datum 15.04.2022
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Nr. i Prot. 2204/22
Broj Prot. 2204/22
Prot. No. 2204/22
Data: 15.4.22
Datum: 15.4.22
Date: 15.4.22

17-01
04

PRISHTINË / A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Komuna e Gjakovës



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË MES

MINISTRISË SË MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE
INFRASTRUKTURËS

DHE

MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

DHE

KOMUNËS SË GJAKOVËS

HYRESE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data: 15.04.2022
Datum: 15.04.2022
Date: 15.04.2022

Njesia organizative	Nr. i Lendes	Vlera
-III-	454-919/3	

Prishtinë, Prill 2022

Në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 Mars, 2019), nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 1 pika 9 dhe 10 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare, Nr. 28/04 Qershor 2008), palët e kësaj marrëveshje:

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të cilën e përfaqëson Ministri Liburn Aliu, në tekstin vijues MMPHI

2. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, të cilën e përfaqëson Ministri Elbert Krasniqi, në tekstin vijues MAPL

dhe

3. Komuna e Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna

lidhin këtë:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është të krijoj lidhje bashkëpunimi në mes të MMPHI-së, MAPL-së dhe Komunës së Gjakovës për projektin: "Rehabilitimi e plotë të Stacionit Transfer dhe pjesës para stacionit në lagjën Ali Ibra në Komunën e Gjakovës".

Neni 2 Objekti i Marrëveshjes

Palët përmes kësaj marrëveshjeje pajtohen që të bashkëpunojnë në realizimin e projektit me kod buxhetor 19039 "Rehabilitimi i plotë të Stacionit Transfer dhe pjesës para stacionit në lagjën Ali Ibra në Komunën e Gjakovës".

Neni 3 Obligimet e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

MMPHI, si organ kompetent obligohet të:

1. Të siguroj deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së projektit;
2. Siguroj se projekti zhvillohet në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe Ligjin Nr. 04/L-194 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtij projekti;
3. Kryej procesin e tenderimit dhe cakton komisionin për hapjen e ofertave dhe vlerësim të tenderit;
4. Emëroj projekt-menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projekteve, si dhe komisionin për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik;

5. Projekt-menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesën e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

Neni 4

Obligimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

MAPL, si organ kompetent obligohet të:

1. Do të koordinoj procesin në mes të Komunës së Gjakovës dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
2. Do të monitoroj procesin e implementimit të projektit në Stacionin Transfer të Mbeturinave.
3. MAPL do të mbështes komunën e Gjakovës në rehabilitimin e hapësirave përballë Stacionit Transfer të Mbeturinave, sipas mundësive financiare nga fondet e MAPL-së.
4. MAPL përgatit raportet finale të përmbushjes së obligimeve të palëve sipas kësaj marrëveshje, deri në përfundimin e projektit.

Neni 5

Obligimet e Komunës së Gjakovës

Komuna, si organ kompetent obligohet të:

1. Lejoj të zhvillohen punimet në Komunën e Gjakovës;
2. Siguroj që personat fizik apo juridik të mos pengojnë në realizimin e këtij projekti;
3. Bashkëpunoj sipas kërkesave specifike që mund të paraqiten gjatë realizimit të projektit.

Neni 6

Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit

1. Me pëlqimin paraprak të palëve marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. Palët mbajnë të drejtën e ndërprerjes së marrëveshjes në rast se konstatojnë se palët nuk i kanë përmbushur obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

Neni 7

Zgjidhja e marrëveshjes

Palët janë pajtuar në mes vete që kjo marrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim.

Neni 8
Numri i kopjeve

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është përpiluar në gjashtë (6) ekzemplarë të njëjtë, prej të cilëve nga dy (2) ekzemplarë i marrin palët nënshkruese.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.


Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës


Liburn Aliu

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal


Elbert Krasniqi

Komuna e Gjakovës


Ardian Gjini

Prishtinë, 15.04.2022